



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport

13 Nr. Zyrtar – 2025

Me datë: 27.03.2025

XIII Nr. / prot. 10 Më Dt. 08.04.2025
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 489 të datës 19.02.2025, dhe në mbështetje të vendimit me Nr. Prot.5398 të datës 12.03.2025 për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në kulturë nga DKRS-ja për vitin 2025, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ndarjen e përfituesëve sipas projekteve për OJQ-të që i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret për subvencionim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, sipas thirrjes publike për aplikim e subvencionimit të OJQ-ve në komunën e Rahovecit.
2. Bashkëngjitur me këtë vendim është lista e përfituesve të subvencioneve në sektorin e rinisë dhe sportit.

LISTA E OJQ-ve PËRFTUESE TË SUBVENCIONEVE NË SEKTORIN E RINISË DHE SPORTIT

Nr	Emri i OJQ-së	Titulli i projektit	Shuma e aprovuar
1	KF - Xërxa	Zhvillimi i aktiviteteve sportive, futbollit dhe shkollës për grupmoshat e reja U11, U13, U15	7.500 €
2	KH - Rahoveci	Pjesëmarrja në garat vendore dhe ndërkombtare, puna me kategoritë e reja	27.000 €
3	Klubi i çiklizmit - Kokrrat	Promovimi i çiklizmit dhe eksplorimi i peisazheve natyrore përmes çiklizmit në komunën e Rahovecit	2.300 €
4	Shkolla e Shahut – Gani Daka	Kampionati ekipor i femrave në shah 2025	1.800 €
5	Klubi i Shahut - Rahoveci	Kampionati ekipor, Superliga e Kosovës	3.200 €
6	Shkolla e Futbollit- Clinic Scoser	Zhvillimi i talentëve të rinj në lojën e futbollit dhe pjesëmarrja në garat regjionale me gjeneratat e reja U11, U13, U15	1.500 €

7	KFV - Rahoveci	Pjesëmarrja në garat zyrtare të ligës së veteranëve në futboll dhe organizimi i turneut memorial “Epopeja e Rahovecit” dhe turneut “Ilaxhi Korenica”	2.000 €
8	KF – Rahoveci	Fuqizimi i sportit të futbollit	31.000 €
9	FC – Rahoveci Futcall	Pjesëmarrja në garat ndërkombtare	10.000 €
10	Shoqata e peshkataveve - Amur	Garat komunale, kraplada memoriale, garat regjionale	1.000 €
11	KV – 17 Korriku	Zhvillimi i volejbollit në komunën e Rahovecit	3200 €
12	KF - Anadrini	Kampionët e Anadrinit 2025	9.500 €
13	Klubi i Basketbollit Grapeland	Zhvillimi i basketbollit elitare në Rahovec	30.000 €
14	Shkolla e Futbollit Grape City	Garimi në gara me tri gjenerata	1.500 €
15	Klubi i Boksit – BB Kastrati	Kampion i boksit të Kosovës	1.600 €
16	KF - Drenoci	Shpallja kampion i ligës regjionale Prizreni	1.500 €
17	Klubi i Boksit - Rahoveci	Fuqizimi i të rinjve nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe boksit	1.300 €
18	Shoqata e Sportit Shkollor	Zhvillimi i sportit shkollor në komunën e Rahovecit	3.200 €
19	Organizata e të rinjve -OKR	Ura kulturore –Festivali i të rinjve për harmoni dhe bashkëjetesë	3.100 €
20	Vizioni i Rinisë për Integrime Sociale	Vetëdijesimi i rinisë për Integrime Sociale	3.100 €
21	SHH. – Kosova	Të rinjtë e Rahovecit forcimi i afësive dhe lidhjeve përmes trajnimeve dhe shkëmbimeve kulturore	13.500 €

Arsyetim

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, me Nr.prot.5398, të datës 12.03.2025, është formuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e rinisë dhe sportit për vitin 2025.

Komisioni ka bërë hapjen dhe vlerësimin e aplikacioneve të cilët kanë konkuruar për subvencione të DKRS-ë, për vitin 2025 duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim.

Nga gjithsej njëzetë e një (21) aplikacione të pranuara, komisioni ka vlerësuar se kriteret për subvencionim i kanë përmbushur njëzetë e një (21) prej tyre.

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me OJQ-të, përfituese të subvencioneve komunale.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës.

Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës.

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1. Qemajl Krasniqi – Kryesues -

2. Egzon Thaqi – Anëtar -

3. Vlora Rashiti - Anëtar -

4. Arsim Kastrati - Anëtar -

5. Servete Demaj – Anëtare -

Sejda